



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 28 prill 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301
Mbledhja filloi në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L
I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Rustem Mustafa, Bojan Stojanovič, Emrush Xhemajli, Eqrem Kryeziu, Melihate Termkolli, Gani Geci, Agim Veliu dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Shkumbin Demaliaj, Ibrahim Selmanaj, dhe Zylfi Merxha.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Blerina Pula.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbaleve të datës 24.03.2009 dhe 14.04.2009
3. Shqyrtimi i planit të Raportit të progresit të Komisionit Evropian
4. Të ndryshme

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të datës 24.03.2009 dhe 14.04.2009

Procesverbalet e datës 24.03.2009 dhe 14.04.2009 u miratuan pa vërejtje

3. Shqyrtimi i planit të Raportit të progresit të Komisionit Evropian

Kryetari i Komisionit - tha, keni marr Raportin në të cilin janë shkoqitur detyrat që dalin për komisionin nga Raporti i Komisionit Evropian. Është përcaktuar edhe dinamika që ne mendojmë të realizojmë këto detyra. Ju njoftoj se javën e kaluar kam takuar Drejtorin e Policisë së Kosovës, bashkë me stafin e tij udhëheqës, dhe përveç tjerave jemi dakorduar për bashkëpunim në detyrat e përbashkëta me policinë e Kosovës. Në dinamikën e paraparë të punës bashkë me referuesin z.Emrush Xhemajli, do tu përgjigjemi detyrave dhe të finalizohet ky plan me kohë.

Emrush Xhemajli – Këtu bëhet fjalë për tri perioda dhe ndarjen e prioriteteve. Tremujori i parë veç ka kaluar sa i përket këtyre vërejtjeve, që janë përfshirë në raportin e progresit të Komisionit Evropian. Tani në tremujorin e dytë, është paraparë të hyn pjesa për anti-diskriminimin, pasaportat, menaxhimi i kufijve, pengimi i hyrje daljeve të kriminelëve, dyfishimi i punëve, dhe statistikave të kriminit. Për këtë periodë, kontrolli dhe dëgjimet publike të nevojshme të segmentit të sigurisë, do të mbahen deri në Qershor. Këtu janë ndarë edhe dy perioda tjera, se si do të procedojmë me çështjet që mbeten. Raporti është bërë në bashkëpunim me stafin dhe ju është shpërndarë, vetëm datat nuk janë caktuar sepse kanë mbetur të precizohen nga stafi.

Kryetari i Komisionit – tha, kërkoj nga stafi që raporti të përmbushet me përpikëri dhe të njoftojmë me kohë për datat e caktuara.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – tha, do t'iu njoftoj për rastin e plaçkitjes, që ka ndodh në policinë e Kosovës. Unë i kam marr hapat e nevojshëm, kam zhvilluar takime me Policinë, Ministrinë dhe faktorë tjerë relevant ndërkombëtarë. Kam shprehur shqetësimin në emër të komisionit, për shkak se ka ndodhur diçka jo e mirë në vendin ku pritet të rregullohet siguria e qytetarëve. Kam shprehur dyshimet e komisionit në hierarkinë e lartë. Unë kam kërkuar një informatë zyrtare, dhe ajo informatë është veç për anëtarët e komisionit, ju veç e keni atë, nuk është për media. Do të përpiqem të ju informoj për çdo informatë që do të disponoj. Unë kam ftuar të gjithë mekanizmat përgjegjës që të hetohet rasti sa më kujdesshëm, sepse ka ndodhur në vendin ku nuk duhej të ndodhte.

Desha të ju njoftoj se z.Nuredin Ibishi është angazhuar nga UNDP-ja, si Konsulent i lartë për të ndihmuar komisionin për një periudhë të caktuar.

Gani Geci – Ne sot e morëm si informatë zyrtare këtë, edhe pse kemi qenë të informuar përmes medimeve për këtë çështje. Në lokalet e drejtorisë kundër kriminit të organizuar

është raportuar një vjedhje. Si anëtarë i komisionit mendoj se është dashur të thirret stafi i drejtorisë kundër krimit të organizuar. Vjedhje mund të ndodhin në çdo vend, kurse në lokalet e drejtorisë është absolutisht e papranueshme, sepse humbet besimi i shoqërisë kosovare ndaj kësaj drejtorie kundër krimit të organizuar. Duhet të merren masa urgjente ndaj personave përgjegjës për këtë rast.

Zafir Berisha - Unë mendoj se kjo është ngjarja më e rëndë që ka ndodhur pas luftës. Më vjen shumë mirë që ju si kryetar, keni reaguar dhe keni kërkuar sqarime. Kjo që ka ndodh në një zyrë ku luftohet krimi është e papranueshme, dhe ne si komision duhet të japim sugjerime institucioneve që të bëhet diçka në këtë drejtim. Asnjë person nuk është shkarkuar apo pezulluar përkohësisht. Nëse ky akt ka ndodh në një institucion të rëndësishëm dhe nuk bëhet asgjë në këtë drejtim, atëherë ne si komision dhe institucionet duke përfshirë edhe ministrinë jemi shumë formal. Ky akt ka qenë mesazhi më i keq që ka dërguar Kosova pas luftës.

Kryetari i Komisionit – tha, jam interesuar për këtë çështje në emër të komisionit dhe jam takuar me drejtorin e departamentit, pastaj me këshilltarin e z.Pajazit, pasi që Ministri ka qenë jashtë vendit, si dhe kam kontaktuar me zyrën ndërkombëtare. Me këtë çështje do të merremi çdo ditë derisa të kryhen hetimet. Procesi i hetimeve po shkon mbarë dhe po kryhen hetime serioze. Unë kam shprehur rezervat e mia për gjithë hierarkinë e strukturave të udhëheqjes së sigurisë.

Shqetësim është edhe gjendja e sigurisë në Mitrovicë, por operacioni është i kontrolluar.

Eqrem Kryeziu – Është rasti më i keq që ka ndodhur dhe ka të bëjë me zhdukjen e dëshmitave kyçe. Unë e kam parasysh periudhën e UNMIK-ut, ku kanë lejuar që pa kurrfarë filtrimi të marrin njerëz të tillë. Askush nuk ka qenë i interesuar që të bëjë seleksionim të njerëzve të ndershëm dhe ti jep përgjegjësi publike, delikate në rastin e sigurisë. Në këto rrethana shqetësuese, më lejoni që juve si kryetar të ju përgëzoj që po merreni me këtë çështje në mënyrën më serioze të mundshme. Kjo do të thotë që ne nuk do të heshtim, kur ndodhin skandale të tilla.

Gani Geci – Unë desha të shtoj diçka, rreth fillimit të ndërtimit të shtëpive nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bashkë me qytetarët. Jemi dëshmitarë se një grup ka filluar pengimin, mirëpo jemi dëshmitarë se Qeveria dhe institucionet lokale, po tregohen të matur. Nuk do të lejohet që një grup të jenë në gjendje të pengojnë kthimin e qytetarëve në vatrën e tyre, qofshin ata shqiptarë apo minoritete tjera. Nëse dikujt nuk i lejohet kthimi në pronën e vet i shkelen të drejtat dhe liritë e njeriut. Edhe ata qytetarë që mundohen të pengojnë kthimin, edhe ata shkelin të drejtat dhe liritë e njeriut. Kërkojmë nga bashkësia ndërkombëtare, EULEX-i që të zbatohet ligji, që qytetarët e Kosovës të kthehen në shtëpitë e tyre, në cilëndo pjesë të Kosovës.

Bojan Stojanovič – Unë nuk kam këtë raport, mirëpo mendoj se SHPK-ja, është si qendër e pakontrolluar sepse punojnë njerëz që nuk i japin imazh të mirë Kosovës. Nëse organizohet kriminaliteti i lartë, ne nuk kemi mekanizma që ata të dalin para drejtësisë. Ne nuk kemi mundur të ndërtojmë mekanizma adekuat që t'iu tregojmë atyre se nuk kanë

të drejtë. Këto raste duhet të ndërpriten. Sa i përket çështjes së sigurisë unë mendoj se duhet të reagojmë qoftë edhe për ngjarje shumë të thjeshta. Nëse ne bëjmë gabime e askush nuk na dënon, atëherë duhet të ketë një mekanizëm që të merret me këtë problematik. Ata që janë përgjegjës të thirren dhe të japin dëshmitë e tyre. Institucionet do të mund të ndërtojnë kapacitete dhe të tregojnë angazhimin e tyre që ti ndalin këto aktivitete. Unë e çmoj gatishmërinë e juaj kryetar dhe do të ju mbështes.

Kryetari i Komisionit – Unë kisha dashur që ta caktojmë tani mbledhjen e ardhshme të Komisionit, mendoj të mbahet me 6 Maj, ku do ti ftojme përfaqësuesin e Agjencionit Antikorrupsion dhe të Policisë së Kosovës që të raportojnë se si po shkon procesi. A pajtoheni me këto propozime?

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këto propozime.

Meqenëse nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit